

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E KAMENICES - OPSTINA KAMENICA
KAMENICA MUNICIPALITY

QENDRA PER SHERBIME ME QYTETARE
CENTAR ZA USLUGU GRADANA
CENTER FOR SERVICES WITH CITIZENS

SH./Z./S. 01 Nr./Br./No. 22871
Nr. i faq. 01 Data 07/08/
Br. Str. 01 Datimi 2026
No. Pg. 01 KAMENICE - KAMENICA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë

Datë: 07.08.2026

Mbështetur në nenin 44 paragrafi 44.1 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 dhe nenin 6 paragrafi 1 dhe 2 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, neni 53 të Statutit të Komunës së Kamenicës, me kërkesë të Kryetarit,

Kryesuesja e Kuvendit, më datë 07.08.2026,

T H Ë R R E T

Mbledhje të Jashtëzakonshme të Kuvendit Komunal e cila do të mbahet ditën e **Mërkurë**, me datë **12.08.2026**, duke filluar nga ora **10:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Kuvendit të Komunës.

Për mbledhje propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Propozim vendim për rifreskimin e listës rezervë të emërtimeve të rrugëve, rrugicave dhe hapësirave publike në Komunën e Kamenicës

Arbnor BEQIRAJ-ELERA
Kryesuesja e Kuvendit të Kamenicës



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Zyra e Kryetarit

Në mbështetje të nenit 13, neni 17, shkronja o), neni 40, paragrafi 40.2, shkronja i) dhe neni 58 shkronja h) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, neni 53 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të nenit 11 dhe 24 të Ligjit nr. 04/L 071, për sistemin e adresave, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/l-031 për procedurën e përgjithshme administrative, neni 5, neni 6 dhe neni 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, neni 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2019 për caktimin e emërtimeve dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik ndërtesa shtëpi objekte dhe parcela kadastrale të lira, neni 9, paragrafit 1.3, të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 16/2019 për procedurat e krijimit dhe administrimit të Regjistrit Komunal të Adresave dhe Regjistrit Shtetëror të Adresave, Vendimi Sh.01.Nr.7082, i datës 25.03.2025, për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe hapësirave publike në Komunën e Kamenicës, Lista Rezervë e Rifreskuar e Emërtimeve të Rrugëve, Rrugicave dhe Hapësirave Publike të Komunës së Kamenicës, Sh.02.Nr.22842, e datës 07.08.2026, dhe të nenit 5 paragrafi 5.1 shkronja o), neni 38 paragrafi 38.2 shkronja l), neni 70 paragrafi 70.1 shkronja h) dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kryetari i Komunës, për mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Kamenicës, që mbahet më _____, sjell këtë:

PROPOZIM VENDIM

Për rifreskimin e listës rezervë të emërtimeve të rrugëve, rrugicave dhe hapësirave publike në Komunën e Kamenicës

1. Me këtë Vendim miratohet Lista Rezervë e Rifreskuar e Emërtimeve të Rrugëve, Rrugicave dhe Hapësirave Publike të Komunës së Kamenicës.
2. Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Lista Rezervë e Rifreskuar e Emërtimeve të Rrugëve, Rrugicave dhe Hapësirave Publike të Komunës së Kamenicës, Sh.02.Nr.22842, e datës 07.08.2026.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse në Komunën e Kamenicës.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, *shfuqizohen* Vendimi Sh.01.Nr.12091, i datës 07.05.2026 dhe Vendimi Sh.01.Nr.12093, i datës 07.05.2026, të nxjerra nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës, të cilat i bashkëngjiten këtij Vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në përputhje me nenin 8, lidhur me nenin 9, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr. 24/2024), si dhe nenin 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Zyrës së Informimit;
- Shërbimit të Kuvendit; dhe
- QSHQ – Arkivit.



Kryetari i Komunës

Kadri Rahimaj



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Datë:	23.04.2026
Për:	z.Kadri Rahimaj /Kryetar i Komunës së Kamenicës
Për:	Kuvendin Komunal të Komunitetit të Kamenicës

Rifreskimi i Listës Rezervë të Emërtimeve të Rrugëve, Rrugicave dhe Hapësirave Publike Komuna e Kamenicës

Bazuar në Vendimin Sh.02, Nr. 4464, të datës 25.02.2025, për emërimin e anëtarëve të Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Kamenicës, komisioni i formuar, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të propozimeve, paraqet këto propozime për shqyrtim dhe miratim.

Procesi është zhvilluar në përputhje me:

- Ligjin Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, Neni 11-Lista e Emrave Rezerve i cili rregullon mënyrën e përcaktimit, kriteret e emërimit të përcaktuar me këtë ligj.
- Udhëzimin Administrativ Nr. 17/2019 – për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtim të listës reserve dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, Pika 1.8 - Lista e emrave reserve, nënkupton listen ku janë inventarizuar emërtimet e miratuar më parë nga kuvendi i komunës dhe janë në listen reserve për përdorim nga njësia përkatëse për zhvillime të reja apo riemërtimet.

Procedura e ndjekur ;

1. **Shpallja e thirrjes publike** – Publikuar më 27.05.2025 në uebfaqen e komunës, 30 ditë nga data e shpalljes, përfunduar më 27.06.2025, janë pranuar gjithsej 41 propozime nga qytetarë, OJQ dhe institucione,
2. **Vlerësimi dhe Hartimi i Listës Rezervë** – Pas shqyrtimit gjitha propozimeve, është përgatitur lista përfundimtare për rifreskimin e listes reserve për aprovim nga Kuvendi Komunal, **Lista Rezerve** përban gjithësej **24 emra**, për shkak të numrit të vogël të kërkesave të paraqitura, komisioni ka pranuar dhe shqyrtuar gjitha propozimet e dorëzuara nga qytetarët apo organizata të tjera para dhe pas përfundimit të afatit të lartëcekur, propozime të cilat janë zgjedhur në përputhje me kriteret e përzgjedhjes si më posht,
3. **Rifreskimi i Listes Rezerve** e cila përmban gjithsej **112 emra**,
4. **Verifikimi i Listës egzistuese Rezervë**, dhe identifikimi i emrave që tashmë janë përdorur për emërtimin e rrugëve dhe hapësirave në Komunën e Kamenicës,
5. **Pastrimi dhe largimi** i disa emrave nga Lista Rezervë.

1. Kriteret e përzgjedhjes,

Komisioni ka zbatuar këto kritere:

- Të ketë domethënie historike, kulturore, artistike ose natyrore për komunitetin;
- Të mos jenë tashmë në përdorim për rrugë apo hapësira të tjera ekzistuese;
- Të jenë në përputhje me rregulloren për emërtimin e rrugëve;
- Të respektoj vlerat e barazisë, tolerancës dhe përfshirjes;

2. Pas shqyrtimit të të gjitha propozimeve, është përgatitur Lista Përfundimtare Rezervë, e cila përmban gjithsej 24 propozime, si më poshtë:”

	Emërtimi i propozuar	Lokacioni	Rrugë/hapësirë publike	Arsyetimi/Kontributi
1	Shkodra	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Emër simbolik, i një qyteti.
2	Rexhep Gashi	Kamenicë	Emërtim për rrugë Hapësirë Publike	Arsimtarë dhe veprimtarë të shquar të çështjes kombëtare në Kosovë.
3	Ganimet Klaiqi	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Gazetar, figurë e shquar në Kosovë.
4	Ramadan Sijarina		Emërtim për rrugë	Dëshmor i Kombit në luftën në Kosovë 1998-99
5	Shemsi Isufi	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Dëshmorë, pjesëmarrës i luftës v.1998-99 në Kosovë.
6	Rahim Rahimaj	Kopërrnicë	Emërtim për rrugë,	Figurë e shquar lokale.
7	Sylë Rama	Kamenicë	Emërtim për rrugë Hapësirë Publike	Kontribues në luftën e UÇK-së, gjatë vitit 1998- 99.
8	Mehmet Zylfiu	Shipashnice e Epërme	Emërtim për rrugë	Veprimtarë, martirë i vrrarë në masakrën e Gjilanit v.1941-51.
9	Kadri Biqkaj	Hogosht	Emërtim për rrugë	Luftëtar i dalluar i luftës së dytë botërore në zonën e Kitkes.

10	Luftëtarit	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Emër me përmbajtje historike mbi luftën e viteve 89-99 në Kosovë.
11	Jozef Suponçiç	Kamenicë	Emërtim për rrugë/shesh	Rreshter, i forcave të Kforit në Kosovë .
12	Adem Kastrati	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Piktor dhe artist i njohur shqiptar nga Kosova.
13	Hafiz Idrizi	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Veprimtari i shquar në çështjet kombëtare dhe fetare në Kosovë.
14	Astrit Dehari	Kamenicë	Emërtim për rrugë, hapësirë publike	Ishte një aktivist politik kosovar Ai studionte mjekësinë dhe ishte përfshirë në aktivitete politike dhe shoqërore për të drejtat dhe të ardhmen e vendit.
15	Halil Tugjeci	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Kontribues në ndërtimin e Institucioneve Komunale mbas luftës së dytë botërore.
16	Komandant Dardani	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Komandant i brigades "Isa Kastrati" në luftën 98-99 në Kosovë.
17	Nazmie Kastrati	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Mësuesja e parë, një ndër figurat e para të arsimit në komunitetin e saj, e njohur për përkushtimin, profesionalizmin dhe dashurinë ndaj dijes. Ajo kontribuoi në edukimin e gjeneratave të tëra nxënësish, duke u bërë shembull i sakrificës dhe përkushtimit në profesionin.

18	Gratë e Dardanës	Kamenicë	Emërtim për rrugë, hapësirë publike	Një emërtim kolektiv që nderon veprimtarinë e grave në lëvizjet kundërshtuese dhe kontributin e tyre në historinë e qytetit.
19	Nositit	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Ky klub është botuesi i materialeve shkencore për historinë e Kamenicës dhe ka luajtur një rol kyç në jetën kulturore të qytetit, duke dokumentuar trashëgiminë për brezat e ardhshëm.
20	Atletëve	Kamenicë	Emërtim për rrugë	%Shërben si një mirënjohje e lartë institucionale për sukseset e jashtëzakonshme të Klubit Atletik "Rogana", i cili ka shndërruar Kamenicën në qendrën kryesore të atletikës në Kosovë dhe rajon.
21	Adem Demaçi	Kamenicë	Emërtim për rrugë	"Mandela i Ballkanit", njeriu që kaloi dekada në burgje për të drejtat e shqiptarëve, simbol i qëndresës së pathyeshme.

22	Faruza Kallaba	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Një pilote shqiptaroamerikane e cila mori pjesë aktive në bombardimet e NATO-s kundër çaqeve serbe në vitin 1999. Me origjinë nga Kamenica, ajo ishte pjesë e Gardës Nacionale të Forcave Ajrore të Illinoisit dhe shërbeu për 78 ditë të intervenimit, duke ndihmuar në misionin për çlirimin e Kosovës.
23	METUSH KRASNIQI	Kamenicë	SHESH(hapësir Publike)	Metush Krasniqi është një nga figurat më të shquara patriotike që lidhet ngushtë me Komunën e Kamenicës, Metush Krasniqi kujtohet si një figurë që frymëzoi breza të tërë me vendosmërinë, guximin dhe besimin e palëkundur në lirinë dhe pavarësinë e popullit shqiptar. Trashëgimia e tij mbetet pjesë e rëndësishme e historisë së rezistencës kombëtare në Kosovë.
24	JAHI MALIQI	Kamenicë	Emërtim për rrugë	Ish pjestarë i Policisë së Kosovës i rënë në krye të detyrës me 15.04.2014.

3. Rifreskimi i Listes Rezervë, e cila përmban gjithsej 112 emra.

EMRAT E LISTES REZERVË KAMENICË	
Lista e emrave rezerv te cilet mbeten ne perdorim nga lista fillestare nga nr 1 deri nr 88	LLoji I ZQP
1 ALI PASHË GUCIA	Rrugë
2 BASHKIMI KOMBËTAR	Rrugë
3 ÇAMËRIA	Rrugë
4 ALI PASHË TEPELENA	Rrugë
5 7 MARSI	Rrugë
6 ANAMALI	Rrugë
7 BESA BESË	Rrugë
8 ÇLIRIMTARI	Rrugë
9 BESA E MALEVE	Rrugë
10 ARBANASI	Rrugë
11 BETEJA E KOSHARËS	Rrugë
12 BILL KLINTON	Rrugë
13 ADRIATIKU	Rrugë
14 ARKITEKT SINANI	Rrugë
15 AFRIM ZHITIA	Rrugë
16 BOLETINI	Rrugë
17 ALEKSANDER MOJSIU	Rrugë
18 EDIT DURHAM	Rrugë
19 KARADAKU	Rrugë
20 EPOPEJA E UÇK	Rrugë
21 FAN NOLI	Rrugë
22 KRUJA	Rrugë
23 MBRETËRIA DARDANE	Rrugë
24 FLAMURI	Rrugë
25 MBRETI PIRRO	Rrugë
26 MEHDI FRASHËRI	Rrugë
27 GJERGJ FISHTA	Rrugë
28 ILIRËT	Rrugë

29	LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT	Rrugë
30	USHTARI I LIRISË	Rrugë
31	MINATORI	Rrugë
32	PRESHEVA	Rrugë
33	MITHAT FRASHËRI	Rrugë
34	MOTRAT QIRIAZI	Rrugë
35	SHTEGU UÇK	Rrugë
36	RILINDASIT	Rrugë
37	ROZAFI	Rrugë
38	TIVARI	Rrugë
39	TOPLICA	Rrugë
40	PANDELI SOTIRI	Rrugë
41	PELLAZGËT	Rrugë
42	TROJA	Rrugë
43	15 Qershori	Rrugë
44	Gurët e Bardhë	Rrugë
45	Lufta e Kikës	Rrugë
46	Lufta e Ushit	Rrugë
47	Lufta e Bujanocit	Rrugë
48	Enver Bajrami	Rrugë
49	Sherif Jonuzi	Rrugë
50	Eglantina	Rrugë
51	Pishtarët e UÇK-së	Rrugë
52	Lufta e Veleçllavës	Rrugë
53	Lufta e Gurit të Zi	Rrugë
54	Gallapi	Rrugë
55	Konaku	Rrugë
56	Sanxhaku I Nishit	Rrugë
57	Shtabi I Bri. 172 - UÇK-së	Rrugë
58	Rexhep Mala e Isa Kastrati	Rrugë
59	Hogoshti Heroik	Rrugë
60	Lumi I Hogoshtit	Rrugë
61	Lumi I Desivojces	Rrugë
62	Lumi I Kremenates	Rrugë
63	Kapetan Shefqeti	Rrugë
64	Kalat Ilire	Rrugë
65	Mësojtorja	Rrugë
66	Tuma Ilire	Rrugë
67	Çameniza	Rrugë

68	Avdi Kastrati	Rrugë
69	Historia e Skenderbeut	Rrugë
70	Topi në Gmicë	Rrugë
71	Lufta e Gjilanit	Rrugë
72	Masakra e Gjilanit	Rrugë
73	Gjyteti	Rrugë
74	Kroni I Bogdanit	Rrugë
75	ANDERSONOVA	Rrugë
76	MIHAÏLO PUPIN	Rrugë
77	DRAGOVACKA	Rrugë
78	BADOVACKA	Rrugë
79	DUKATSKA	Rrugë
80	DUNAVSKA	Rrugë
81	BEOGRADSKA	Rrugë
82	MILEŠEVSKA	Rrugë
83	GAGRINOVA	Rrugë
84	BORO VUKMIROVIQ	Rrugë
85	GNJILANSKA	Rrugë
86	GOLEŠKA	Rrugë
87	MLADOSTI	Rrugë
88	MONTANA	Rrugë
	EMRAT E RI PER RIFRESKIM nga nr.rendor 89 deri nr 112	
89	SHKODRA	Rrugë
90	REXHEP GASHI	Rrugë
91	GANIMET KLAÏQI	Rrugë
92	RAMADAN SIJARINA	Rrugë
93	SHEMSI ISUFI	Rrugë
94	RAHIM RAHIMAJ	Rrugë
95	SYLË RAMA	Rrugë
96	MEHMET ZYLFIU	Rrugë
97	KADRI BIQKAJ	Rrugë
98	LUFTËTARIT	Rrugë
99	JOSEPH SUPNCIC	Rrugë
100	ADEM KASTRATI	Rrugë
101	HAFIZ IDRIZI	Rrugë
102	ASTRIT DEHARI	Rrugë
103	HALIL TUGJECI	Rrugë
104	KOMANDANT DARDANI	Rrugë

105	NAZMIE KASTRATI	Rrugë
106	GRATË E DARDANËS	Rrugë
107	NOSITIT	Rrugë
108	ATLETËVE	Rrugë
109	ADEM DEMAÇI	Rrugë
110	FARUZA KALLABA	Rrugë
111	METUSH KRASNIQI	SHESH(hapësir Publike)
112	JAHI MALIQI	Rrugë

4. Pas verifikimit të Listës Rezervë, kemi identifikuar emrat e mëposhtëm që tashmë janë përdorur për emërtimin e rrugëve dhe hapësirave në Komunën e Kamenicës. nga nr.1 deri nr 14

1	28 NËNTORI	Rrugë
2	ARBËRIA	Rrugë
3	AVNI RRUSTEMI	Rrugë
4	DIASPORA	Rrugë
5	ALBANËT	Rrugë
6	HAMZË JASHARI	Rrugë
7	KONGRESI I MANASTIRIT	Rrugë
8	FLAKA E JANARIT	Rrugë
9	FOLEJA E UCK	Rrugë
10	DËSHMORËT E KIKES	Rrugë
11	ZAHIR PAJAZITI	Rrugë
12	BOLNICKA	Rrugë
13	GALILEO GALILEJ	Rrugë
14	BOSANKSA	Rrugë

5. Pas verifikimit të Listës Rezervë, janë pastruar dhe larguar disa emra. Nga nr.1 deri nr10

1	DIELLI	
2	LONDRA	
3	ODA	
4	MALI I KISHES	
5	ENVER HOXHA-XHAXHI	
6	SHIPTAN	
7	GURI I ÇAPLES	
8	TRINGA	
9	TOPI NË KRANIDELL	
10	RAGUZA	

Rekomandimet e Komisionit

- Lista Rezervë t'i propozohet Kuvendit Komunal për miratim.
- Pas miratimit, lista të publikohet në faqen zyrtare të komunës.


Përfundim


Ky raport përmbledh punën e Komisionit për rifreskimin e listës reserve për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike në Komunën e Kamenicës në përputhje me udhëzimin administrativë Nr. 17/2019 – për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtimie të listes reserve dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave dhe ligjin në fuqi Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave. Procesi është zhvilluar në mënyrë transparente, gjithëpërfshirëse, duke respektuar parimet e përfaqësimit qytetar me domethënie historike, kulturore, artistike ose natyrore për komunitetin.

Emrat e propozuar, ne si komision i kemi pranuar duke u mbështetur në përmbledhjen e shkurtër biografike të bashkëngjitur në propozime. Në disa raste kemi bërë edhe hulumtime shtesë për të verifikuar informacionet publike për të siguruar saktësinë e të dhënave të paraqitura, mirëpo në të shumten e rasteve nuk kemi hasur në burime publike të mjaftueshme për disa nga propozimet e dorëzuara për emra rrugësh apo hapësira publike.

Komisioni;

Sylejman Kallaba(DUPH) Kryesues 

Edon Dermaku(DZHED)Anëtar 

Ramush Ismaili(DPKGJ)Anëtar..... 

Edon Canaj(DBF)Anëtar..... 

Besim Morina(DSHPAIE)Anëtar..... 




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 07.05.2026



Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d), nenit 17, shkronja o), nenit 40, paragrafi 40.2, shkronja i), të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28, datë 15 qershor 2008), nenit 7 dhe nenit 24 të Ligjit Nr. 04/L-071 për Sistemin e Adresave, si dhe nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja o), nenit 38, paragrafi 38.2 të Statutit Sh.01.Nr. 20203, të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, me qëllim të emërimit të sheshit në Komunën e Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 04.05.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR EMËRTIMIN E SHESHIT "Metush Krasniqi"

1. Miratohet vendimi për emërtimin e sheshit në Komunën e Kamenicës me emrin "Metush Krasniqi".
2. Sheshi nga pika 1 e këtij Vendimi ndodhet në rrugën "Skënderbeu", në kuadër të projektit për ndërtimin e sheshit në Komunën e Kamenicës, i realizuar si investim i Komunës së Kamenicës.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas publikimit bëhet zyrtar në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Arsyetim

Duke qenë se sheshi në Komunën e Kamenicës aktualisht nuk ka emërtim zyrtar, paraqitet nevoja për përcaktimin e një emri të tij, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për sistemin e adresave.

Emërtimi i sheshit kontribuon në identifikimin më të lehtë të hapësirave publike, në përmirësimin e orientimit urban dhe në pasurimin e identitetit lokal të Komunës së Kamenicës.

Propozohet që sheshi të mbajë emrin e Metush Krasniqit (1928–1986), i lindur në fshatin Dajkoc të Komunës së Kamenicës, i cili ishte arsimtar dhe veprimtar i shquar i çështjes kombëtare. Ai dha kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit në gjuhën shqipe dhe në organizimin e veprimtarisë kombëtare, për çka u përdoq dhe u burgos disa herë nga regjimi i kohës. Për shkak

të veprimtarisë së tij atdhetare dhe kontributit të çmuar për vendin, ai përfaqëson një figurë të rëndësishme historike për komunën dhe më gjerë.

Për këto arsye, propozohet miratimi i këtij Propozim-Vendimi.


Vendimi i u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorive Komunale, MAPL-së dhe QSHQ – Arkivit.

Kryesuese e Kuvendit Komunal


Arbnore BEQIRAJ FERA



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 07.05.2026

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d), neni 17, shkronja o), neni 40, paragrafi 40.2, shkronja i) të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008"), të nenit 11 dhe 24 të Ligjit nr. 04/L 071, për sistemin e adresave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 29/27, dhjetor 2011) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-176 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me ligjin nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, nenit 5, neni 6 dhe neni 7 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 17/2019 për krijimin dhe administrimin e listës alfabetike për emërtime listës rezervë dhe vendosjen e tyre në regjistrin komunal të adresave, neni 5 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 14/2019 për caktimin e emërtimeve dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik ndërtesa shtëpi objekte dhe parcela kadastrale të lira, Vendimi Sh.01.Nr. 7082, i datës 25.03.2025, për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe hapësirave publike në Komunën e Kamenicës, Lista me emërtimet e reja të listës rezervë, me nr. Sh.01.Nr.10745, e datës 24.04.2026, dhe të nenit 5 paragrafi 5.1 shkronja o), neni 38 paragrafi 38.2 shkronja l), dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 04.05.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për rifreskimin e listës rezervë të emërtimeve të rrugëve, rrugicave dhe hapësirave publike në Komunën e Kamenicës

1. Me këtë vendim miratohet rifreskimi i listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe hapësirave publike në Komunën e Kamenicës.
2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë lista me emërtimet e reja të listës rezervë, Sh.01.Nr.10745, e datës 24.04.2026, e hartuar nga Komisioni i caktuar me Vendimin Sh.01.Nr.7082, të datës 25.03.2025, për caktimin e Komisionit për rifreskimin e listës rezervë për emërtimin e rrugëve, rrugicave dhe hapësirave publike në Komunën e Kamenicës, si dhe lista me emërtimet e larguara nga lista rezervë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe drejtoritë përkatëse në Komunën e Kamenicës.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Kamenicës, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr.

08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në ueb-faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorive komunale, MAPL-së dhe QSHQ-Arkivit.

Kryesuese e Kuvendit Komunal

Arbnore BEQIRAJ FERA

